
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data: ____ .12.2025

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - MALLRA

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Objekti i procedurës: “Blerje automjete te reja, tip autoburgje të blinduara me kategori të sigursë (blindimit) “BR6”, për sistemin e Burgjeve për vitin 2025”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):

34100000-8 Automjete;
34114210-4 Automjete për transportin e të burgosurve;
34114000-9 Automjete të specializuara;

Vlera e fondit limit: **66,433,333** (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë PA TVSH**, ose ose 688,571.03 (gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një pikë zero tre) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më datë 17.12.2025 është 96.48 lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor, **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 9**;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të kontratës**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/b e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar *jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të lotit* është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*”.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për*

zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilnaceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, *fax*, *email*, *website*, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që

janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

3. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht një servis në pronësi/me qera ose mënyra të tjera të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacion si më poshtë:

- Licencën e kategorisë VII.3.B.1 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove” dhe me legjislacionin për lejet dhe licencat, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.
- Dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje të vlefshme jo më pak se afati i garancisë/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Dokumentacioni i kërkuar të paraqitet në sistem.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 2 të ligjit me nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ligji me nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM me nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, VKM me nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës me nr. 1546, datë 29.3.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për realizimin e kontratës objekt prokurimi, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore. Gjithashtu me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se disponojnë mjediset e përshtatshme të autorizuara për kryerjen e shërbimeve të riparimit brenda periudhës së garancisë

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM–së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e

kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

6. Operatori ekonomik për të vërtetuar se plotëson specifikimet teknike për: *“Materiali i celikut të blinduar, - celik i forte, qelp armato ose materile të avancuara që ofrojnë mbrotje kundër armeve të zjarrit dhe shperthimeve. Celiku i blinduar, duhet të jetë minimumi 6.5 mm.”*; duhet të paraqesë një çertifikatë të vlefshme, të lëshuar nga një entitet vendas ose europian dhe ku të citohet materiali i testuar dhe kalibrat e plumbave.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë test raport nga kompania që bën konvertimit të mjetit, për testimin e materialit të celikut të blinduar me min 6.5 mm.

8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë raport tesim (nga subjekti që bën konvertimin të mjetit) për testimin e xhamit në përputhje me **standardin EN 1063:1999** (ose ekuivalent).

Argumentimi për pikat 6, 7, 8: Në nazë të nenit 77, “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikot se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...] 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 “Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 dhe 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i*

ndryshuar parashikohet se: [...] “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. [...] 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Kërkesa për paraqitjen e raport testeve për materialin e çelikut të blinduar dhe për xhamin që janë materialet kryesore për mjetet e blinduara objekt prokurimi, është vendosur në mënyrë që të sigurohet që materiali i përdorur të jetë në përputhje me standartet e duhura dhe sipas specifikimeve teknike. Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili është “mjete të blinduara” për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, specifikimet teknike të kërkuara, është e rëndësishme që të sigurohet që malli do të jetë sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për t’u paraqitur është i parashikuar në kuadrin ligjor të sipërcituar, duke i dhënë mundësinë autoritetit kontraktor t’u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve që ofrojnë me specifikimet teknike.

9. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjeti është prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të është prodhuar për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila të jetë e shoqëruar me çertifikatën e konformitetit (CoC).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallit, objekt prokurimi. Duke qenë se mjetet janë kërkuar të jenë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE, detyrimisht është kërkuar paraqitja e çertifikatës së konformitetit si dokumenti zyrtar i cili vërteton se një produkt plotëson standartet europiane të sigurisë, cilësisë, performancës, emetimit të gazrave dhe mbrojtjes mjedisore. Gjithashtu çertifikata është një nga dokumentet e detyrueshëm që shoqëron automjetin për të vijuar me regjistrimin e tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor

10. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë garancie ku të jetë përcaktuar periudha e garancisë jo më pak se 2 vite ose minimumi 40,000 km, në varësi se cili kusht do të plotësohet i pari.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar.

Deklaratat shërbejnë si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi do të jetë në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha

Adresa: Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6 /337 Tirane (në krah të Gjykatës së Lartë) – www.obp.al

riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues, si dhe garantohet kryerja e shërbimeve për riparimin e mjeteve, gjatë periudhës së garancisë.

11. Deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjeteve të targuara dhe regjistruara në pronësi të autoritetit kontraktor përfitues, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë.

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjetet do të dorezohen pranë AK të pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Specifikime teknike te mjetit:

Të përgjithshme:

Lloji i automjetit:
Sasia :
Kilometra të përshkruara:
Viti i prodhimit:

Minibus për transport te burgosurish

Minibus për transport burgosurish
2 (dy) copë
0 km
Min 2024

Motori:

- Motori turbo Diezel Min 2150 cc
- Lenda djegese Naftë, jo më pak se Euro 6.
- Fuqia motorike Min 135 Kf
- Numri i cilindrave Min 4
- Konsumi i kombinuar per 100 km Max 15 litra /100km.

Transmisioni:

- Kutia e shpejtësise (Kambio) Automatik ose Manual (5-marshe ose më shumë).
- Shpejtësia Min 100 km/ore.

Permasat:

- Gjatesia Min 6350mm
- Gjerësia Min 2050 mm
- Lartësia Min 2500 mm
- Distanca Aksiale Min 4000 mm

Aksesore shtese:

- Me timon hidraulik dhe ne krahun e majte
- Frenat me sistem ABS, ASR
- Airbeg per shoferin dhe pasagjerin.
- Xhamat elektrike ne dyert e para.
- Ajer i kondicionuar Klima.
- Sistemi elektrik 12V, si dhe te jete konform normave te CE.
- Mbyllje e centralizuar e dyerve, komandim ne distance.
- Radio + USB

A. Kërkesa të përgjithshme

Ngjyra e bardhe.

B. Kërkesa të veçanta

1. Pjesa e pasme e mjeteve duhet të përbëhet nga tre seksione. Seksioni i parë duhet të jetë seksioni i personelit të sigurisë (policisë), ndërsa seksioni i dytë dhe i tretë duhet të jenë seksionet e transportit të të burgosurve.
2. Mjetet duhet jenë të blinduara minimumi sipas Testit Ballistik BR6.
3. Materiali i celikut te blinduar, - celik i forte, qelp armato ose materile te avancuara qe ofrojne mbrotje kunder armeve te zjarrit dhe shperthimeve. Celiku i blinduar, duhet te jet minimumi 6.5 mm. Per kete duhet te paraqitet nje certifikate e vlefshme, e leshuar nje nje entitet europian dhe ku te citohet materiali i testuar dhe kalibrat e plumbave.

4. Te paraqitet test raport nga kompania qe ben konvertimit e mjetit, per testimin e materialit te celikut te blinduar me min 6.5 mm
5. Mjet AntiShperthim – perdorimi i materialeve per dyshemete e blinduara me mbrotje
6. Paisjet e komunikimit – te avancuara per te siguruar lidhje te vazhdueshme ne ekipet e sigurise.
7. Seksioni i policisë duhet të ketë vende për tre persona me rripa sigurie.
8. Duhet sigurohet vend për ruajtjen e armëve në anët e vendeve.
9. Seksioni i të burgosurve duhet ndahet në dy seksione, 3 në të djathtë dhe 3 në të majtë, duke lejuar transportimin e gjashtë të burgosurve.
10. Vendet në seksionin e të burgosurve duhet të jenë prej druri (stola) në profile metalike dhe të sigurohen lidhje për pranga poshtë.
11. Muret anësore dhe tavani duhet të jenë të veshura me material kompozit alumini të bardhë minimumi 4 mm.
12. Seksioni i të burgosurve duhet ndahet me profile metalike, dhe anët e djathta dhe të majta do të jenë të veshura me kompozit alumini minimumi 4 mm.
13. Dyert e kyçshme duhet te instalohen në derën e pasme dhe në pjesën e përparme të ndarjes së të burgosurve.
14. Dyshemeja duhet te mbulohet me PVC rezistente ndaj ujit minimumi 12 mm për ndarjen e policisë dhe fletë metalike me liste alumini për ndarjen e të burgosurve.
15. Tavani duhet të ketë llamba ndriçimi në të tre seksionet.
16. Furgoni duhet te ket ventilatorë turbo në tavan si në ndarjet e të burgosurve ashtu edhe në ndarjen e policisë. (3 njësi)
17. Një kondicioner shtesë duhet te instalohet mbi sediljen e shoferit për ndarjen e pasme.
18. Furgoni duhet te kete një ngrohës shtese për të ngrohur ndarjet e pasme.
19. Dritare vëzhgimi katrore të blinduara duhet të instalohen në anët e djathta dhe të majta ku do të ulen policët, dhe dritare vëzhgimi të ngushta dhe të gjata të blinduara duhet te jene në ndarjen e të burgosurve dhe në dyert e pasme.
20. Xhami i përparmë i automjetit, dritaret e dyerve, kabina e shoferit dhe ndarjet e pasme do të jenë të blinduara minimumi sipas BR6.
21. Xhami i blindur duhet te jete minimumi 38.50 mm trashesi
22. Testimi i xhamit duhet te jet bere nga nje trup europiane sipas Test Raportit EN 1063:1999
23. Automjeti duhet të ketë një sinjalizues, sistem njoftimi me zë dhe sirenë.
24. Furgoni duhet te ketë një shkallë rrëshqitëse për derën e mesme.

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT